

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Tod Investment” Sh.p.k.**

**KAPITULLI I**  
**EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

**Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **“Tod Investment” Sh.p.k.**, këtu më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.4 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

**Neni 2**

**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga “Qemal Stafa”, Zona Kadastrale 8370, Nr Pasurie 10/258, Kati 8 shkalla 1 ,Tiranë.
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

**Neni 3**

**Objekti**

### 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:

- A. Import-eksport, shitje e produkteve (mallrave) dhe materiale të ndryshme industriale. Studim tregu dhe asistencë në kërkimin për fonde, investime dhe kredi financiare. Hartim i planeve të biznesit për projekte të ndryshme dhe ofrimi i asistencës në menaxhimin gjatë zhvillimit (zbatimit) të projektit por edhe në etapat në vijim. Shërbime projektimi. Projektimi dhe zbatimi i projekteve arkitekturore. Punime dhe projektme sisteme elektrike, si dhe çdo projekt tjetër teknik i nevojshëm gjatë realizimit të një ndërtimi. Ndërtim, punime restaurimi dhe rikonstruksione, realizimi i veprave publike.
- B. Projektim dhe ndërtimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vetë dhe për të tretë; Shitja e objekteve / njesive të ndërtuara si investitor dhe/ose dhënia e tyre me qira; Shfrytëzimin e zonave malore apo bregdetare/plazheve për qëllime turistike, duke administruar, dhënë me qira, ndërtuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argetimit, bar, restorante në zona turistike etj.; Importi-eksporti shitja me shumicë e pakicë e lendeve të para të ndërtimit, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitareve, kondicionere, sisteme aspirimi, mobileri, pajisje zyrash, kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike etj. Transporti i mallrave dhe udhëtareve brenda dhe jashtë vendit; Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave, fiskale, ligjore etj.
- C. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe/ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin përsosor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- D. Tregtimi i energjisë, instalimi i sistemeve fotovoltaike si edhe zhvillimi i shfrytëzimit të çdo energjie tjetër të rinovueshme. Projektim, zhvillim dhe asistencë në platformat dhe bizneset on line.
- E. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme.

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja**

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

**KAPITULLI II**  
**KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E**  
**KAPITALIT**

**Neni 5**  
**Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njqindmije) Lekë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm :
- **Z. Kris Naço**, shtetas shqiptar, lindur më 23.09.1997 , banues në Tiranë, me numër personal J70923050J , zotërues i një kuote të Shoqërisë, me vlerë 100,000 (njqindmije) Lekë, duke përfaqësuar 100% (njqind) të kapitalit themeltar me të drejtë vote.
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## Neni 6

### Transferimi i Pjesëve-Kuotave

- 6.1 Çdo Ortak mund t'ia transferojë pjesët e tij në kapitalin e Shoqërisë çdo pale të tretë, me kusht që Ortaku transferues t'u ketë njoftuar më parë me shkrim Ortakëve të tjerë të paktën 1 (një) muaj para ("**Periudha e Njoftimit**") numrin e pjesëve për t'u shitur, çmimin e shitjes, identifikimin e palës së tretë dhe çdo kusht tjetër lidhur me transferimin e pjesëve. Ortakët e tjerë duhet t'i përgjigjen njoftimit të Ortakut transferues nëse dëshirojnë të blejnë pjesët sipas kushteve të vendosura në njoftim brenda Periudhës së Njoftimit. Në rast të një përgjigjeje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Ortaku transferues mund të procedojë me transferimin e pjesëve te pala e tretë.

## KAPITULLI III

### ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

## Neni 7

### Asambleja e Përgjithshme

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratorët;
  - Emëron dhe shkarkon administratorët;
  - Emëron dhe shkarkon ekspertin(ët) kontabël dhe/ose likuiduesin(it) e Shoqërisë;

- Përcakton shpërblimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve;
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët;
- Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- Merr vendim për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

## Neni 8

### Thirrja

- 8.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori(rët) apo secili prej Ortakëve sipas legjislacionit në fuqi.
- 8.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës, për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
- 8.4 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë. Administratori(ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.

## Neni 9

### Procesi i vendimmarrjes

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që është e nevojshme, por në çdo rast të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave të Shoqërisë. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

- 9.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë, në lidhje me çështje për të cilat ligji nuk kërkon një shumicë të cilësuar, përcaktuar në pikën 9.4 më poshtë.
- 9.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakëve të pranishëm në lidhje me:
- i. Ndryshimin e Statutit;
  - ii. Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - iii. Shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
  - iv. Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme për vendimet sipas pikës 9.4 quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave të Shoqërisë. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 10**

#### **Administratori**

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:
- Z. Kris Naço**, shtetas shqiptar, lindur më 23.09.1997 , banues në Tiranë, me numër personal J70923050J , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
- 10.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 10.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.

- 10.5 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin administratorit, administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
  - Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
  - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve të konsoliduara, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - Dorëzimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit të dokumenteve dhe të të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
  - Raportimin në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
  - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 10.6 Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 10.7 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

## KAPITULLI IV VITI FINANCIAR - SHPËRNDARJA E FITIMEVE

### Neni 11 Viti Financiar

- 11.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 11.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2019.

#### **Neni 12**

#### **Shpërndarja e Fitimeve**

- 12.1 Pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimeve.
- 12.2 Në rast se pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare Shoqëria rezulton me humbje, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me mbulimin e humbjeve.

### **KAPITULLI V**

### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 13**

#### **Ligji i Zbatueshëm**

- 13.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

#### **Neni 14**

#### **Të ndryshme**

- 14.1 Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë secila.



Tiranë, më 25.10.2019

**ORTAKU I VETEM**

**Kris Naço**

KRIS NAÇO  
